

Gjykata Supreme e Kosovës, kolegji i përberë nga gjyqtaret: Enver Peci, kryetar, Shukri Sylejmani dhe Emine Kaçiku, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, si procesmbajtës, ne kontestin administrativ sipas padisë se paditëses, “E.” Sh.p.k nga Peja, te cilën e përfaqëson A. A., kundër te paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës ne Prishtine, për shkak te anulimit te vendimit, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim te jashtëzakonshëm te vendimit gjyqësor te paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit te Gjykatës se Apelit te Kosovës, AA.nr.73/2016 te datës 26.04.2016, ne seancën e kolegjit te mbajtur me 23.06.2016, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim te jashtëzakonshëm te vendimit gjyqësor e paditëses “E.” Sh.p.k nga Peja, paraqitur kundër aktgjykimit te Gjykatës se Apelit te Kosovës, AA.nr. 73/2016 te datës 26.04.2016.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e atakuar te Gjykatës se Apelit te Kosovës, AA.nr. 73/2016 te datës 26.04.2016, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditëses E.” Sh.p.k nga Peja , ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore ne Prishtine-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1554/2012, i datës 11.01.2016.

Paditësja kësaj gjykate i ka parashtrua kërkesë për rishqyrtim te jashtëzakonshëm te vendimit gjyqësorë me te cilën e konteston ligjshmërinë e aktgjykimit te Gjykatës se Apelit te Kosovës- Departamenti për Çështje Administrative, AA.nr. 73/2016 te datës 26.04.2016, për shkak te shkeljes se dispozitave te procedurës administrative, ndërsa

nga përmbajtja e kërkesës rrjedh se paditësi pretendon edhe ne shkelje te drejtës materiale, me propozim qe te aprovohet si e bazuar kërkesa për rishqyrtim te jashtëzakonshëm te vendimit gjyqësor njashtu qe, aktgjykimi i Gjykatës Themelore ne Prishtine dhe aktgjykimi i atakuar i Gjykatës se Apelit te anulohen dhe çështja te kthehet ne rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës ne baze te nenit 53 te Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit te aktgjykimit te atakuar, kërkesës se paditësit për rishqyrtim te jashtëzakonshëm te vendimit gjyqësorë dhe shqyrtimit te shkresave tjera te lendes ka gjetur se:

Kërkese është e pa bazuar.

Nga shkresat e lendes rezulton se me aktgjykimin e Gjykatës se Apelit te Kosovës- Departamenti për Çështje Administrative, AA.nr. 73/2016 te datës 26.04.2016, është refuzuar si pa bazuar ankesa e paditësit, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore ne Prishtine-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1554/2012 i datës 11.01.2016, me te cilën është refuzuar kërkesëpadia e paditëses me te cilën ka kërkuar qe te anulohet vendimi i te paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës, nr. 03/978/12 te datës 11.12.2012.

Duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim te jashtëzakonshëm te vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit te aktgjykimit te kontestuar, shkresat e lendes dhe vlerësimit te pretendimeve ne kërkesë, gjeti se gjykata e shkalles se dyte drejt ka vepruar kur ka refuzuar si te pa bazuar ankesën e paditëses dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës se shkalles se pare.

Qëndrimin juridik te Gjykatës se Apelit si te rregullt dhe te bazuar ne ligj ne tersi e aprovon edhe kjo gjykatë, nga se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshi me shkelje te dispozitave procedurës administrative e as te drejtës materiale siç pretendon paditësi ne kërkesë.

Paditësja ne kërkesë për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm te vendimeve gjyqësore mes tjerash pretendon se, Drejtoria Kadastrale ne Prishtine ka shkelur nenin 76 te Ligjit

për Procedurën Administrative nga se lidhur me kërkesën për regjistrim të paluajtshmerisë së paditëses duhet të vendoset me vendim e jo me konkluzion si dhe faktin se pezullimi nuk e përcakton asnjë dispozitë ligjore. Me tutje në kërkesë paditësja thekson se në momentin e lidhjes së kontratës për shitblerjen e paluajtshmerisë me shitësin nuk ka pas të vendosur barre tatimore nga Administrata Tatimore e Kosovës, duke iu referuar nenit 32 paragraf 2, të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010 për zbatimin e ligjit për Administratën Tatimore të Kosovës, për të cilin konsideron se nuk është zbatuar pasi që paditësja nga e paditura dhe gjykata nuk ka marrë përgjigjeje se si është caktuar barra tatimore. Po ashtu konsideron se gjykata me këtë rast ka shkelur dispozitat ligjore të nenit 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore nga se nuk i ka konstatuar shkaqet nga të cilat është goditur aktgjykimi, e as shkaqet për të cilat ajo kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme pas vlerësimit të pretendimeve të paditëses në kërkesë gjeti se të njëjtat janë të pa bazuara nga se nuk ka gjetur shkelje të nenit 76 të Ligjit për Procedurën Administrative se në këtë çështje administrative ZKK ka qenë detyrë të vendosë me vendim e jo me konkluzion. Kjo dispozitë ligjore me tepër i referohet procedimit administrativ i cili duhet të përfundohet me nxjerrjen e vendimit përfundimtar. Drejtoria Kadastrale e KK Prishtine, lidhur me kërkesën e paditëses vendosi me konkluzion e që në praktik akti administrativ emërtohet ,vendim, aktvendim, konkluzion etj. Me rëndësi është përmbajtja e aktit administrativ e jo emërtimi i tij kështu që konkluzioni në fjalë i përmban të gjitha elementet të një akti administrativ të parapare me nenin 84., të Ligjit për Procedurën Administrative.

Sa i përket pretendimit të paditëses se në momentin e lidhjes së kontratës së shitblerjes së paluajtshmerisë së parcela kontestuese nuk ka pas barre tatimore, kjo gjykatë konstaton se paditësja kërkesën për regjistrimin e paluajtshmerisë e ushtron me datën 10.05.2012, ndërsa në evidencën e Drejtorisë Kadastrale të KK Prishtine po me këtë datë nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) është vënë barra tatimore në parcelën 161-5 me pronar legjitim A. K., Qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë në këtë drejtim si të rregullt dhe të bazuar në ligj e aprovon edhe kjo gjykatë, pasi që duke iu referuar Udhëzimit Administrativ 15/2010, për zbatimin e ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, neni 32.1, përcakton se “barra tatimore është ngarkesë apo pengës që një person ka në pasurinë e tjetrit si siguri për një borxh apo

obligimi”. Duke vlerësuar rastin konkret u vërtetua se barra tatimore është vendosur ne pasurin e shitësit te pasurisë se paluajtshme ne parcelën 161-5 te KK Prishtinë me pronar legjitim A. K., i cili nuk i ka përmbush obligimet e tij tatimore. Pragrafi 3. i nenit 32. te Udhëzimit Administrative te cekur me larte përcakton qarte se “ barra tatimore regjistrohet ne regjistrat publik, me qellim te vendosjes se përparësisë se ATK ne lidhje me transakcionet e caktuara dhe palët tjera te interesuara”. Pretendimet e paditëses se ne kohen e lidhjes se kontratës se shitblerjes nuk ka pas barre tatimore, se nuk është zbatuar neni 32. Paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ 15/2010 i cekur me lart pasi qe nga e paditura dhe gjykata nuk ka marre përgjigjeje se si është caktuar barra tatimore, sipas vlerësimit te kësaj gjykate janë te pa bazuar, nga se paditësja Drejtorisë se Kadastrit ne Prishtine ju ka drejtua me kërkesë për bartjen e parcelës me date 10.05.2012 edhe pse kontrata mbi shitblerjen e pasurisë është vërtetuar ne gjykate me 27.04.2012. Drejtoria e Kadastrit gjate vendosjes lidhur me kërkesën ka konstatua se ne momentin e arrijtes se kërkesës ne parcelën kontestuese është vendos barra tatimore e cila si e tillë sipas dispozitave te Ligjit për ATK dhe procedurat si dhe Udhëzimit Administrative për zbatimin e këtij ligji sipas nenit 33. paragrafi 3. te Ligjit për ATK dhe procedurat, duhet te regjistrohet ne zyrën komunale kadastrale te Agjencisë Kadastrale te Kosovës ne lidhje me pronën e paluajtshme dhe kjo barre tatimore ka përparësi kundrejt te gjitha barreve te regjistruara me vone ose interesave te siguruara ne lidhje me pasurin e tillë.

Çështja se si është vendos kjo barre tatimore nuk ka qene objekt i këtij kontesti administrativ, pasi qe siç u cek ma larte barra është vene ne parcelën kadastrale 161-5 te pronarit te ligjshëm A. K., nga i cili ATK kërkon pagesën e detyrimit ne paluajtshmerin e tij dhe sipas paragrafit 2. te nenit 33. te Ligjit për ATK, barra tatimore e vendosur vazhdon te ekzistoj derisa detyrimi te jete shlyer ose behet i pa zbatueshëm. Andaj i mbetet kontraktuesve t’i zgjedhin çështjet kontestuese sipas kontratës se lidhur me date 27.04.2012.

Nga te cekurat me larte, Gjykata Supreme gjeti se gjykata e shkalles se dyte ne këtë çështje administrativo-juridike drejt ka aplikuar dispozitat e procedurës administrative, dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative, Ligjit për Procedurën Administrative, Ligjit për Administratën Tatimore te Kosovës dhe procedurat si dhe Udhëzimit Administrative nr. 15/2010, për zbatimin e Ligjit nr.03/L-222 për ATK, njashtu qe thëniet e paditësit ne kërkesën për rishqyrtim te jashtëzakonshëm te vendimit

gjqësor janë te pabazuara, nga se nuk janë me ndikim ne vërtetim tjetër te gjendjes faktike nga ajo te cilën e kane vërtetuar gjykatat e shkalles me te ulet.

Sipas vlerësimit te kësaj gjykate, aktgjykimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshme, ne arsyetimin e te njëjtit janë dhënë arsyeza te nevojshme për faktet vendimtare te cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Gjykata vlerëson se e drejta materiale drejt është zbatuar dhe se nuk është shkel ligji ne dëme te paditësit.

Nga si u tha me sipër, ne baze te nenit 54 paragrafi 1 te Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVES

Me 23 qershor 2016, ARJ.nr.22/2016

Procesmbajtësi,  
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,  
Enver Peci